KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE
SELIA E SHENJTË

IMAM HYSENI

CEREMONIA PËRKUJTIMORE E IMAM HYSENIT

IMAM HYSENI

Imam Hyseni është djali i dytë i Imam Aliut e i Fatime Zehras, i nipi i Profetit Hazretit Muhamed. Ai është i treti nga të 12 Imamët dhe i pesti nga familja e Ehlibejtit.

Ka lindur në Qytetin e uruar Medine, ditën e martë, më datën 5 të muajit Arab Shaban, të vitit të 4 të Emigrimit.

Me emrin Hysen e ka pagëzuar Profeti Hazreti Muhamed. Ka patur këta mbiemra: Zeqi, Shepir, Shehid, Sept. Si Imam Hyseni, ashtu dhe Imam Hasani janë lavdëruar me Ajete Hyjnore dhe me shumë fjalë Profetike të panumërta, sa që është e detyrueshme për çdo besimtar mysliman dashuria dhe respektimi i tyre. Imam Hyseni, që nga mesi e lartë, i përngjante babait tij, Imam Aliut, kurse nga mesi e poshtë i përngjante gjyshit të tij Hazretit Muhamed. Pas vdekjes së gjyshit të tij, Hazretit Muhamed, ka qëndruar gjithmonë pranë atit të tij, kështu që diturinë dhe edukimin e ka marrë prej të atit.

Pasi ra dëshmor Imam Aliu në Qofe, në vitin 40 të emigrimit, u kthye me gjithë fëmijë në Medine, kur bëri paqen Imami Hasani me Mavijen.

Mavija nuk la mënyrë pa përdorur, si me anë letrash dhe me persona që të detyronin Imamin të njihte si trashëgimtar të birin, Jezidin, por ai jo vetëm nuk i`u bind, por edhe nuk e njohu. Pas vdekjes së Mavijes, i biri Jezidi, përdori çdo mënyrë që ta përulë Imam Hysenin që t'i bindej, por Imami Hyseni nuk e njohu.

Meqënëse në Medine rrethi i Jezidit nuk e linin të qetë, Imami e pa më të pëlqyer largimin e tij prej Medine për në qytetin e uruar Mekë.

Në Mekë, populli i Qofes, i dërgoi shumë delegatë dhe kërkesa, ku shfaqnin dëshirën për t`a patur Halife në vendin e tyre, duke i`u betuar, se me çdo kusht do të mbanin flamurin e Ehlibejtit.

Imam Hyseni dërgoi kushëririn e vet Myslim Ykajlin, që të lajmëronte dhe të njoftonte popullin e atjeshëm, se ai e pranoi propozimin e tyre, mirëpo ata e vranë atë dhe dy djemtë e tij.

Imami pas një kohe, u nis për në Qofe me 19 dashamirës dhe pjesëtarë të Ehlibejtit dhe me të tjerët që e shoqëronin, bëheshin 73 vetë. Këtë vendim nuk ja pëlqeu i vëllai i tij, Muhamed Hanefiu dhe i kushëriri Abdull-llah, i biri i Abazit, të cilët i thanë, që qofelitë janë të pabesë, por ai u tha që unë nuk i shmangem destinacionit të Zotit e se do të bëj çdo sakrificë për të vërtetuar predikimet, që ka bërë im gjysh dhe nuk do ta le në asnjë mënyrë, që kombi i pabesë të shkelë e të demaskojë fenë tonë të shenjtë e të lartë. Në atë kohë imoraliteti ishte shumë i përhapur në kombin e Jezidit dhe ata ishin mysliman për faqe e reklamë, se në realitet ata ishin pa fe e besim.

Imami, pas kësaj me gjithë pjesëtarët e dashamirësit e tij, u nisën për në Qofe. Sundimtari i Qofesë, i mallkuari Ybejdulla Zijadi, mori një urdhër prej Jezidit, që ta kundërshtonte Imam Hysenin. Ybejdi, përgatiti një ushtri nën komandën e Ymer Saadit, i cili i doli përpara Imamit.

Populli i Qofesë, duke parë masat që mori Ybejdi kundër Imamit, e thyen fjalën dhe pohimin që kishin dhënë dhe në vend që ata të ndihmonin Imamin, përkundrazi e luftuan, duke e lënë vetëm me një grusht besnikësh në mes të një ushtrie shumë të madhe.

Ymeri, i biri Saadit, sipas urdhrit të Ybejdull-llahut, kërkoi nga Imami që t'i bindej Jezidit. Imam Hyseni me vendosmëri e refuzoi këtë propozim dhe me trimëri shembullore, pa u trembur nga vdekja dhe vuajtjet, por me besnikët e pakët që kishte, vendosi të derdhë gjakun në fushën e Qerbelasë, për shpëtimin e gjithë njerëzisë. Sado që Ymer Saadi përdori çdo mjet që ta bindte Imam Hysenin, duke i prerë në atë vend të nxehtë edhe ujin e Eufratit, Imami qëndroi i patronditur, me fëmijët, gratë e miqtë, që kishte me vete.

Imam Hyseni, kur pa se po ndizej lufta, të gjithë atyre që kishte rrotull i`u propozoi që të kthehen, meqë nuk kishin ndalim nga ushtria e Jezidit, sepse qëllimi kryesor i Jezidit ka qenë vetëm për Imamin. Mirëpo, rrethi i tij, këtë nuk e pranoi për ta lënë vetëm nipin e Profetit të dashur, duke preferuar që të vdisnin së bashku me të.

Lufta krisi dhe nisën të dalin në fushë një nga një, sipas zakonit që ishte në atë kohë.

Dita, që filloi lufta, ishte e dhjeta ditë e Muajit Muharrem, të parit muaj të vitit Arab (61) të emigrimit. Lufta filloi që në orët e para të mëngjesit dhe vazhdoi deri në mesditë. Kishte rënë dëshmorë gjithë ushtria e Imamit dhe Imami mbeti i vetëm në mes të një ushtrie mizëri të armikut; kishte mbetur i fundit i biri i Imamit, Zejnel Abedini, që quhet Aliu i mesëm dhe ky pasi u vesh kërkoi leje prej Imam Hysenit, për të dalë në mes të luftës.

Imam Hyseni, nuk i dha leje në dhe në mënyrë të prerë i tha: "Ti je i vetmi filiz i Ehlibejtit, që do të vazhdojë prej teje sa të jetë jeta, udha e vërtetë e Muhamed Aliut". Pas këtyre fjalëve Imami me gjithë Zejnel Abedinin u mbyllën brenda në çadër, ku Imam Hyseni i dorëzoi të birit të gjitha amanetet e shenjta dhe porositë shpirtërore, që i kishte trashëgim nga i ati i tij, Imami Aliu dhe nga i vëllai, Imam Hasani.

Imam Hyseni, pasi e plotësoi këtë detyrë të shenjtë, u la lamtumirën e fundit grave dhe fëmijëve, duke u nisur për në fushën e luftës, prej së cilës nuk do të kthehej më. Ishte një vajtim e një mallëngjim i rrënqethshëm në këtë çast dhe fjalët e të shoqes, Shehri Banu, ishin përvëluese, plot dhimbje e lotë: "O burri i uruar e i shenjtë! Ku më le mua të mjerën në mes të një ushtrie armike! Unë për ata jam e huaj, meqë nuk jam prej kombësisë arabe! Kur të biesh dëshmor Ti, kushedi çfarë fati më pret mua!". Një vaj i madh e mbuloi Shehri Banunë. Imami u mundua që t`a ngushëllonte dhe kështu i dëshpëruar i hipi kalit të tij, ngjeshi shpatën, e veshi Harkanë e gjyshit, Hazretit Muhamed. Doli në fushë të luftës i përvëluar nga etja dhe i tronditur nga dhimbja e fëmijëve.

Ushtria e Jezidit, sapo e panë që Imami doli në sheshin e Luftës, i lanë traditat e vjetra të luftës, që dilnin një e nga një dhe dolën një shumicë, Imamin e vunë në mes, duke e qëlluar me shigjeta e shpata. Imami u bëri ballë me trimëri, këtyre sulmeve, por nga plagët e shumta që kishte marrë,

më në fund i`u pre fuqia. Gjaku i rridhte si lumë dhe ra nga kali. Kur e panë armiqtë, që Imami ra nga kali, u sulën me shpata për t'i prerë kokën e uruar.

Ajo ditë ishte e premte dhe koha e faljes së drekës. Dy a tre armiq të fëlliqur ju hodhën për t'i prerë kokën Imamit, por fuqia e fortë shpirtërore e Imam Hysenit i detyroi që të largoheshin pa mundur që të kryejnë veprën e tyre çnjerëzore. Kur i mallkuari Shemri Dhilxhysheni, i cili i kishte dhëmbët si të derrit, pa se u kthyen shokët e tij pa e kryer detyrën që u kishte ngarkuar, si i tërbuar vërsulet vetë mbi Imamin. Imamit, që ishte në përuljen e faljes së drekës, ai i ra me shpatë dhe i ndau kokën prej trupit, të birit të Imam Aliut dhe të nipit të Profetit Muhamed.

Në këtë moment, u duk sikur qielli lëshoi mbi lëmshin e dheut një ulurimë të tërbuar. Toka u drodh dhe horizonti u nxi, për të marrë pjesë në gjëmën e madhe që ngjau.

Kur panë fëmija e Imamit, se kali mori arratinë filli vetëm, duke hingëllirë e derdhur lot, vaji i tyre u shoqërua me ulurimën e qiellit e me errësirën, që u shpërnda anembanë rruzullimit.

Ushtria e mallkuar ishte duke shkelmuar trupin e uruar të Imamit e të dashurve të tjerë.

Kjo ushtri, sapo mbaroi krimin e saj çnjerëzor, shkoi në çadrën ku ishin fëmijët e Imamit, i plaçkitën dhe i ofenduan me fjalë të ndyra e të vrazhda. Shemri i mallkuar, kur e pa se ishte gjallë Zejnel Abedini, u vërsul me tërbim që t'i shkëpuste jetën dhe atij, por u mbajt me kurajo nga halla e tij Zejnepia. Pasi i zhveshën fëmijët dhe ju morën rrobat që kishin, i hypën në deve, duke i rrjeshtuar pas kokës së Imam Hysenit dhe të dëshmorëve të tjerë, të cilët i kishin vënë nëpër maja të heshtave. Haulimi, i biri Jezid Abdahuit, e mbante kokën e uruar të Imam Hysenit mbi heshtën e tij dhe ishte flamurtar, që udhëhiqte turmën për në Qofe.

Ai ishte i pari, që me të arritur në Qofe, paraqiti kokën e Imamit, tek Ybejd Zijadi. Ybejdi i mallkuar, pati guximin dhe i ra me një shkop buzëve të kokës së Imamit. Në këtë çast u ndodh dhe Zejdi, i biri i Erkanit, një nga shokët e Profetit Muhamed, i cili kur e pa këtë poshtërsi, filloi të qajë me zë të lartë e i tha Ybejdit: "T'u thefshin ato duar se këtyre buzëve që po ju bie ti me shkop, unë i kam parë shpesh herë duke i puthur Hazreti Muhamed!".

Ybejdi nga këto fjalë u nevrikos dhe i tha: "Po të mos ishe plak, do të kisha vrarë!" dhe urdhëroi që të dëbohet jashtë.

Pas këtyre, Imam Zejnel Abedinin, së bashku me fëmijët, me një skenë jashtëzakonisht të dhimbshme, duke përdorur armiqësi e fjalë fyese, i nisën nga Qofeja për në Sham, ku Jezidi i mallkuar ju dha shumë mundime e pas një muaji i lejoi fëmijët e Ehlibejtit të ktheheshin në Medine.

Kur arritën në Medine, gjithë populli i madh e i vogël ju dolën përpara duke qarë dhe kjo zi e ky vajtim i popullit të Medines, zgjati për tri ditë rresht.

Vjershëtorët e shkrimtarët muhamedanë kanë shkruar qindra e mijëra vjersha vajtimi dhe dorëshkrime e lavdërime të panumërta mbi këtë ngjarje të shëmtuar të kryer nga Jezidi e fisi i tij.

Varri i Imam Hysenit, që ndodhet në Qerbela, vizitohet nga të gjithë dashamirët e Ehlibejtit. Tyrbeja e tij është madhështore dhe ka brenda shumë sende të vyera e të vjetra, që s'mund të çmohen.

Me kaq, merr fund shkurtimisht jetëshkrimi i Imam Hysenit, dëshmorit të Qerbelasë, e cila në historinë e tij është shumë më e gjerë.

MATEMI

Matemi është agjërimi i zisë, ose zija përkujtimore, që mbahet në dhjetë ditët e para të hënës Muharrem.
Fjala Matem është persiane dhe ka kuptimin Zi. Dhe me të vërtetë, ndër këto ditë, përkujtohen ngjarjet e hidhura të Qerbelasë, të cilat kanë ndodhur pikërisht në këtë hënë, në vitin 63 të Hixhretit. Vihen në dukje të gjitha sakrificat, vetëmohimi dhe flijimi vetes që u bë atje për mbrojtjen e demokracisë dhe dispozitave fetare, për interesin e përgjithshëm, për të mirën e popullit. Kjo sakrificë mbeti një simbol i pavdekshëm dhe shembull i paharruar heroizmi që përkujtohet me respekt çdo vit në këtë hënë. Shumë prej popullit islam përmendin me përunjësi, në çdo vit, këtë ngjarje. I përkujtojnë me respekt, gjunjëzohen përpara këtij kujtimi dhe derdhin lot për këtë ndodhi. Populli me këtë përkujtim, përjetëson emrin e Madh të Imam Hysenit, Atit të Dëshmorëve të Qerbelasë dhe urren, përbuz dhe mallkon veprat e Jezidit të mallkuar. Kjo ngjarje ka lënë përshtypje të madhe në të gjithë botën dhe ka mbetur kujtim i hidhur ndër të gjithë.

Dëshmorët e Qerbelasë, me Hysenin e Madh në krye, ranë në fushën e nderit, duke qenë të etur e të djegur për një pikë ujë në vapën e gushtit. Bota Islame e çmon këtë therori dhe për nder të tyre, dhjetë ditë me rradhë, nuk pi ujë. Kjo vepër nuk është një urdhëresë fetare, por një dëshirë fakultative, e vënë në zbatim vullnetarisht nga të gjithë. Si shenjë zije, ndër këto ditë populli mënjanon gjithë lukset, shkon nëpër teqet për t'i përkujtuar këto ngjarje të paharrueshme me zemër të pikëlluar dhe me fjalët lakonike në gojë : "Ja Imam! Ja Hysen!".
Gjatë këtyre ditëve, me rastin e ngjarjeve të Qerbelasë, përkujtohen edhe të gjithë ngjarjet e sakrificat e mëparshme, që janë bërë për të mirën e popujve dhe në favor të interesit të përgjithshëm. Përmenden një nga një vuajtjet e të gjithë Profetëve, që kryen misionin e tyre të shenjtë në të mirën e botës. Çmohen, lartësohen këto sakrifica dhe përulen përpara kujtimit të tyre. Kështu, ditët e përkujtimit marrin një kuptim të përgjithshëm dhe mund të quhen ditët e përkujtimit ose përkujtimi i të gjithë sakrificave botërore, të bëra për të mirën e njerëzisë dhe për interesat e përgjithshme.

Të gjitha përkujtimet bëhen gjatë dhjetë ditëve të ndara, në këtë mënyrë:

1. Natën e parë përkujtohen:
   - Mundimet e Profetit Adem, për të kryer misionin e shenjtë. Përmenden dhe krimi që ka ndodhur midis djemve të tij dhe ndodhitë që i kanë ngjarë për t'u përsosur.
   - Përkujtohen ngjarjet e Profetit Nuh dhe misioni i tij, i cili ka vuajtur shumë prej popullit të tij të pabesë.
   - Përmenden vuajtjet e Ibrahimit, që u hodh në zjarr prej Nemrudit të mallkuar, pse donte t'u drejtonte besimin njerëzisë.
   - Përmenden vuajtjet e të Madhit Jusuf, që u hodh në pus prej vëllezërve të tij, për të vetmin faj, sepse ishte i pastër dhe kishte fituar simpatinë e prindërve.
   - Përmenden vuajtjet e Musait prej Faraonit të mallkuar, pse ky i fundit, donte t`a sundonte popullin me dhunë dhe të ishte Perëndia e tyre.
   - Dhe në fund, vuajtjet që i`u bënë prej prepotentëve Krishtit të Madh, për të vetmin faj, sepse i`u përkushtua pa rezervë njerëzve, duke predikuar rrugën e drejtë, të paqes, drejtësisë, vëllazërimit dhe përsosmërisë njerëzore.

2. Nata e dytë i kushtohet vuajtjeve të Profetit Muhamed, i cili vuajti dhe u mundua për të nxjerrë popullin nga errësira e skllavërisë, në dritën e mirësisë të njerëzimit.

3. Nata e tretë i kushtohet të Madhit Ali, i cili u sakrifikua dhe ra dëshmor, për të udhëhequr botën në rrugën e mbarë. E zhdukën, sepse ishte apostulli i së vërtetës.
4. Nata e katërt i kushtohet të Madhit Imam Hasan, i cili u helmua tradhëtisht prej ambicieve të njerëzve të ligj, sepse ishte paqedashës dhe predikonte cilësitë e saj.
5. Në natën e pestë, tregohet biografia e Imam Hysenit, lindja dhe jeta e tij.
6. Në natën e gjashtë, këndohet emigrimi i Imam Hysenit nga Medina në Mekë, që të mos provokonte grindjen me Jezidin.
7. Nata e shtatë i kushtohet martirizimit të Myslim Ykajlit, kushëririt të Imam Hysenit, i cili shkoi në Qofe (Irak), si delegat i Imamit dhe si u tradhëtua, në fund ra dëshmor me dy djemtë e tij, Miftari dhe Ibrahimi, njeri shtatë vjeç dhe tjetri tetë.
8. Natën e tetë përkujtohet udhëtimi i Imam Hysenit për në Qofe, ku shkonte i ftuar nga populli, për t'i drejtuar në rrugën e mbarë.
9. Natën e nëntë përkujtohet mbërritja e Imam Hysenit në Qerbela, ku mori letrën e Myslimit, me të cilën e lajmëronte të mos shkonte në Qofe, se populli e ktheu fjalën. Kur mori Imam Hyseni letrën, derdhi lot dhe tha: "S'mbeti më tash të rrojmë! Duhet të vdesim!".
10. Natën e dhjetë që është nata e fundit, tregohet lufta e Qerbelasë, ku Imam Hyseni ra dëshmor në fushën e nderit, bashkë me shokët e tij. Ai u martirizua, por kujtmi i tij u përjetësua dhe përkujtohet çdo vit.
Matemi është vajtimi që bën populli, për Hysenin e Madh, i cili u persekutua dhe ra dëshmor në fushën e nderit, për të mbrojtur kushtetutën fetare, për lirinë e popullit, për të mirën e tij. Ai sakrifikoi jetën e tij, u martirizua buzë thatë, në vapën e gushtit të shkretëtirës arabe, por mbajti gjallë flamurin e lirisë, prestigjin e demokracisë fetare, ashtu siç i kishte hije, siç e kishte për traditë prej atit të tij, të Madhit Ali.
Kjo vepër mizore i`u bë nga prepotenti i kohës, Jezidi i mallkuar, biri i Mavijes, mbretit të Shamit, në Siri. Me vdekjen e Mavijes, Jezidi qëndroi në fronin e të atit, pa vënë në zbatim dispozitën fetare që ishte se Kryetari duhej të zgjidhet me dëshirën e popullit. Arbitrarisht zuri fronin, pa bërë asnjë formalitet ligjor. Popullata filloi të revoltohej për këtë padrejtësi, por ky me vrasje e terror i shtypi dhe i`u imponua.
Si siguroi pozitën e tij në Sham, kërkoi të zgjeronte influencën edhe në vende të tjera. Mirëpo kishte frikë, se nuk do të mund t`a realizonte këtë ëndërr derisa ishte gjallë Imam Hyseni, nipi i porfetit Muhamed dhe i biri i të Madhit Ali. Këtë frikë e kishte, sepse e dinte mirë që Hyseni gëzonte të gjitha cilësitë dhe meritat si dhe adhurohej shumë nga populli arab.
Për këtë përdori gjithë djallëzitë dhe vendosi që me çdo mënyrë të detyronte Hysenin ta njihte zyrtarisht si mbret. Më parë dërgoi proklamata në të gjitha guvernat arabe, me anën e të cilave u bënte të njohur fronëzimin. Të gjithë e përbuzën këtë fronëzim, por heshtën nga frika. Imam Hyseni në këtë kohë ka qënë në qytetin e Medinës, bashkë me farë e fisin e tij.
Jezidi i dërgoi urdhër guvernatorit të Medinës dhe i kërkonte të thërriste Imamin dhe ta detyronte me çdo mënyrë ta njihte për të parë atë. Kur u thirr, Imami u përgjigj: "Kjo punë është e rëndë dhe nuk më përket mua. Vini në zbatim ligjin tradicional fetar dhe mblidhni përfaqësinë e popullit. Po të vendosin ata, unë s'kam asnjë kundërshtim".
Fjalët e Hysenit, guvernatori i`a referoi Jezidit, i cili u zemërua për këtë refuzim dhe dha urdhër që të kapej Imami dhe të detyrohej me forcë, ose të pranonte njohjen, ose të ekzekutohej. Imami e pa që po egërsohej situata dhe mori gjithë farë e fisin dhe shkoi në Mekë.
Populli i Mekës e priti me krahë hapur dhe i bëri nder të madh. Me qindra, me mijra njerëz vinin në vizitën e Tij dhe i përuleshin Imamit. Ngjarja bëri bujë të madhe dhe Jezidi u trondit shumë nga kjo punë, pse kishte frikë se mos Hyseni revoltonte popullin kundër tij, për aktin ilegal që bëri. E tillë gjë u përhap në të gjitha viset. Qofelinjtë dëgjuan këto lajme dhe menjëherë i shkruan Imamit me mijra letra dhe i luteshin me bindje që t'i vizitonte dhe t'i drejtonte sytë prej tyre, se

do ishin gjithë jetën besnikët e tij. Si i`u përsëritën shumë herë këto lutje, Imami deshi të shkonte, por miqtë e tij e këshilluan të dërgonte më parë një delegat të hetonte, pasi ata ishin njerëz të frikshëm dhe s'e mbanin besën. Atëherë vendosi dhe dërgoi Myslim Ykajlin, kushëririn e tij për hetime. Myslimit në fillim i treguan bindje të madhe dhe ky i shkroi Imamit të nisej për Qofe. Imami u nis për atje dhe po udhëtonte. Jezidi i dëgjoi këto lajme dhe nga frika e revoltimit, mori masa. Dërgoi atje guvernator terrorist, i cili vrau, preu dhe i frikësoi Qofelinjtë. Ata nga frika harruan çdo besë. Atëherë u kërkua kapja e Myslimit dhe ra në luftë me të. Pas një lufte të përgjakshme, Myslimi ra dëshmor dhe puna e tij u shkatërrua.
Para se të vdiste, Myslimi i shkroi letër Imamit dhe e porositi që të mos shkonte në Qofe, se ata e thyen besën. Imami duke udhëtuar, arriti në vendin Qerbela, ku mori lajmet e hidhura. I dëshpëruar qau dhe tha: "S'na mbeti më tash për të rrojtur! Më mirë të vdesim!"
Pyeti ç'i thoshin atij vendit. Kur ju përgjegjën Qerbela, tha: "Ah! Ky qenka vendi i belasë që më tregoi im atë. Këtu jemi të destinuar të presim fatin!"
Atëherë ngritën tendat atje dhe qëndruan të pritnin destinimin e tyre. Jezidi mori vesh dhe dërgoi me dhjetëra mijë ushtarë t`a kapte. Ushtria arriti atje dhe filloi lufta. Me mijëra dashamirës erdhën në ndihmën e Imamit, por ky nuk i mbajti. I falenderoi të gjithë dhe i`u tha: "Ju falemnderit shumë. Shkoni në punët tuaja. Unë jam nisur për të vdekur! Nuk dua miqtë e mi t'i shtie në mundime!" Nga këto fjalë të gjithë u larguan. Imami që të gjithë i bekoi. Mbetën vetëm 72 vetë, të cilët i`u lutën me këmbëngulje se dëshironin të vdisnin me të. Fjalët e tyre i pasonte të qarët. Imami i falenderoi që të gjithë për këtë vendosmëri dhe i`u lut Zotit për ta.
Dhe me të vërtetë, që të gjithë këta ranë dëshmorë përpara Imamit, kur filloi lufta.
Imami, kur mbeti fill vetëm, nuk u dorëzua. Luftoi si burrë, derisa ra dëshmor në fushën e nderit, ashtu siç e kishte për traditë prej të atit të tij.
Kështu Hyseni i Madh u shtri dhe u përlye me gjak, në pluhurin e shkretëtirës arabe! Trupi i tij u shkel dhe u përbuz prej Jezidit e Jezidistëve të shitur, por kujtimi i tij mbeti gjithë jetën i gjallë në zemrat e gjithë popullit, i cili për vit përsërit zinë, i bën ashuren përkujtimore dhe derdh lot e psherëtimë dhe sot për të, duke vajtuar e duke i kënduar trimëritë e tij.
Kjo është ceremonia e ashures së përmotshme, e cila kryhet me një ceremoni të veçantë, duke marrë pjesë me mijëra njerëz në të.
Me t'u çelur Matemi, ashurja vihet në zjarr dhe të nesërmen me një ceremoni fetare, këndohet me zë të lartë vajtimi (Mersije). Pastaj bëhet lutja fetare në një heshtje të madhe zije.
Populli fillon të hajë ashuren, duke përkujtuar Imamin e duke mallkuar Jezidin dhe pasuesit e tij.

ASHURJA

Ditën e dhjetë të Matemit, për t'i dhënë fund kësaj periudhe agjërimi, zhvillohet një ceremoni e fundit në teqe. Kjo ceremoni fillon në fund të natës së dhjetë, besimtarët pinë ujin e jetës, sherbetin dhe mbas kësaj vihet ashurja në zjarr dhe vazhdon të nesërmen "Dita e Ashures". Ashurja është ëmbëlsira e posaçme që merr emrin e kësaj dite. Dita e njëmbëdhjetë do të thotë Ashure. E dhjeta ditë e muajit Muharrem shënon përvjetorin e vdekjes së Imam Hysenit në Qerbela. Ashurja gatuhet me grurë, ujë, niseshte, fasule, bath, misër, fiq të thatë, rrush të thatë, arra, sheqer (ose mjaltë, pekmez, musht), kanellë si dhe shumë prodhime të tjera që dalin nga toka.

Në ceremoninë fetare recitohet me zë të lartë (Mersije) bëhen lutje fetare në një heshtje zie. Pastaj bëhen vizita, populli dhe besimtarët hanë ashuren.

Ashurja vazhdon përgjatë gjithë muajit të hënës Muharrem, ku të gjithë besimtarët e pregatisin këtë ëmbëlsirë jo vetëm për familjet e tyre por edhe për të gjithë të afërmit, duke u uruar mirësi, paqe, dashuri midis njëri tjetrit.

MERSIJE

O ju që mbani Matemin, për të bijt' e Mustafasë,
Dhe po bëni duanë, myhibë të Ali Abasë.
Duhet gjithnjë të mendoni, Shehidin e Qerbelasë,
Mëngjes e mbrëmje të qani, për të birin e Zehrasë.

Del o Ah! Si vetëtima, shih qiellin vrima-vrima,
Mbyte me lot botën të tërë, syri im,
Me ngashërim të qajmë pa pushim,
Hidhërimet le t'i presim me durim.

Jepi shpatën e mallkimit, Jezidit fytyrë keqit,
Edhe shokëve të atij, se morën mësime prej dreqit.
Duhet dashuri të madhe, t'i japim Hysen Meleqit,
Të mos e nxjerrim nga mendja, Shahun e nëntë feleqit.

Dorën mos e largo kurrë, nga ata të bijtë e Zehrasë,
Kokën mos e ndaj kurrë, prej Hasanit Myxhtebasë.
Lëre kryet për Hysenin, Shehidin e Qerbelasë,
Në do të fitosh Rizanë e Krijuesit të Meulasë.

Prej Mahsherit nuk ka frikë, kush ka dorëzuar xhanë,
Që e do Xhaferr Sadiknë, Zejnel Abedinë Sulltanë.
Do Hadinë, do Mehdinë, Teki Asqeri sa janë,
Duaj dhe Musa Qazimnë, bashkë me Ali Rizanë.

Këta të gjithë hoqnë, nga armiqtë shumë u ndoqnë,
U therën e në zjarr u dogjnë, për të shpëtuar njerinë,
Por jo si Hysejn Aliu, që u shkri si qiriu dhe mbeti dritë në jetë,
Ti je një shtyllë (Diell) i lartë, që nuk shkruhesh dot në kartë,
Të falem, Ja Imam i vërtetë.

E dhjeta ditë e Matemit, që u vra Imami ynë,
Ju muhibët e Hajderit, të dashur ashikanë,
Derdhni nga dy pika loti, të kënaqni Perëndinë,
Këtu provohen burrat, që e duan vërtet Alinë.

1. Me fuqinë e Zotit të Madh, djalli i nëmur dhe i mallkuar, qoftë larg nesh kurdoherë,
2. Me emrin e Atij Zoti të vërtetë, Zotit fuqimadh e mëshirë shumë, ne të bindurit e Tij, nga djalli e djallëzitë, shpëtuam për jetën e jetëve.
3. Por Ai Zot i vetëm dhe i pa shoq, nuk ka për të gjykuar, veçse për dashurinë tonë, më të afërmit e Tij, e në veprat e tyre të mira, nuk ka për të pyetur, veçse për armiqësinë tonë me armiqtë e të afërmve të Tij, dhe për veprat e tyre të liga e të mërzitura.
4. Edhe kështu kush është miku i të dashurve të Tij, është edhe miku i Perëndisë, kush është i dashur ndaj Hysenit, është besnik tek Hazreti Muhamed-Aliu, dhe i dashur tek Perëndia; kush nuk e do Hysenin është anëtar i Jezidit, dhe qoftë i mallkuar për jetën e jetëve. Amin!

VAJTIM
Për dëshmorët e Qerbelasë

Si kur u shemb Alemi, së prapthi ktheu rrota,
Thërret e qan gjith bota, për Ty ja Hysejn!
Qiejt u ngjyen në gjak, dita u vesh në të zeza,
Hëna e humbi çdo rreze, për Ty ja Hysejn!

Edhe retë e mbajnë Matemin, të zeza janë vargosur,
Derdhin shi brengosur, për Ty ja Hysejn!
Fytyrën na e çorrën, si Hëna ashtu Dielli,
Po qan toka dhe Qielli, për Ty ja Hysejn!

Ju thye mezi çarkut, yjet seç u hodhën,
Si shiu poshtë rrodhën, për ty Ja Hysejn!
Detet të dhembsurojnë, lumenjtë në rrjedhim,
Çon gurët në rrokulim, për Ty ja Hysejn!

Nga ndarja jote po qajmë, secili Ty të kërkon,
Ku je Ti Xhanan po thonë, për Ty ja Hysejn!
Si gjyl fytyra jote, me ndarjen u gjakos,
Çdo gonxhe u plagos, për Ty ja Hysejn!

Me gjuhë të tyre Shimrin, të gjithë e mallkojnë,
Mervanin e nëmojnë, për Ty ja Hysejn!

Ah! Hysejn! Vah! Hysejn!
Shah Hysejn, Penah Hysejn!
Myryv-vet Ja Hysejn!
El medet Ja Hysejn!

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Ti je drita mbi gjith' dritat e dynjasë
Drit' për mbi shehidët e Qerbelasë,
Ti je syri i djathtë i Resulull-llahut,
Ti je thelbi i zemrës Fatime Zehrasë!

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Bukuria e Zotit, o Drit' e Xhihanit!
Shpirt i njerëzisë, mëshirë e Rrahmanit,
Në fytyrën tënde Vesh-shemsi është shkruar,
Në dritën e ballit, sir-rret e Kuranit!

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Gyshi yt Ahmedi, gjyshja Hatixheja,
Ati Yt Hajdari, Mëma Fatimeja,
Ungji Yt Xhaferri, që ka fluturuar,
Yt vëlla Hasani, që e kanë helmuar!

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Kryet Tënd që pati sirrin e Perëndisë,
Gushën që ta puthte, shpirti i gjithësisë,
Ti kurban u bëre para Jezidisë,
Me hanxhar të therën, tuf' e djallëzisë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Saki mos na lër, ditën e mahsherit,
Pa na dhënë ujë, prej Hauzit Qeutherit,
A quhen njerëz ata që i munduan,
I vranë e i therën të bijtë e Pejgamberit?

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Erdhi Muharremi, Hëna e Matemit,
Ti në këtë Hënë, shkove prej Alemit,
Pleq, të ri, të varfër, të gjithë për ty qajnë,
Shënohet Matemi dhe për Ty Zi mbajnë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Nga helmi burbuqet, me gjak janë ngjyer,
Nga derti gjithë lulet, grisur dhe shqyer,
Me ngjarjen e Qerbelasë qan i gjori bilbil,
Se gjaku i Ali Abasë, kuq si trëndafili.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Këmishën e zisë retë e patën veshur,
Qemerin e helmit, në mes e kanë ngjeshur,
Si breshër i derdhin lotët, nga të asaja,
Asnjë lule s'duket me buzë të qeshur.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

U kërrus dhe çarku, Yjet u derdhnë,
Nga tmerri o Dritë, që të gjithë u verdhnë,
Filluan dhe detet, krejt të hidhërohen,
Pas shkëmbit me valë, u përpoqnë e u drodhnë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Inxhija, Jakuti fare vlerë s'kanë,
Në atë rrugën tënde, si gurë lumi janë,
Ai gjak Jakuti, që u derdh në tokë,
Mallkon për minut' Shimrin dhe Mervanë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Ç'bënë faqezinjtë, për bijtë e Profitit,
Jezidi mos daltë kurrë prej Lanetit,
Ty dhe fëmijën kush i do si shpirti,
I shpëtuar qoftë, ditën e kijametit.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Selam paç prej Zotit, Ti edhe fëmija,
Mallkim le të ketë gjithë Jezidia,
Edhe në Mahsher qofshin nga Zoti të largët,
Qofshin të mallkuar nga Perëndia.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Kur mbeti pa ujë, në fushë të shkretë,
Ah ujët e gjallërisë, ç'humbi tatëpjetë!
Ç'pati çarku i Qiellit, s'të dha një pikë,
Davaxhi i jemi të gjithë nat' e ditë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Po s'u lut për ne, Yt Gjysh o Dritë,
Sëmundja, mëkati, na i griu mushkëritë,
Shpresojmë neve që i duam fëmijët,
Në mahsher pa ujë, s'ngelim atë ditë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Në mahsher pëqinë të kam për të zënë,
Me gjithë fuqinë, s'të kam për të lënë,
O Zot mos na lër pa ujë Qeutheri!
Për Ali Hajdarin që e do Pejgamberi.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Xhebrail-emini dhe Melaiqet' të tërë,
Të Arshit, të Qyrsit sa janë në serë,
Ty edhe Fëmijës, selam le t'u japim,
Kjo që t'u bë Ty, njeriu s'i është bërë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Hajretiu! Te pragu po mbështet fytyrën,
Shahu i mirësisë, na bëj qerem Tinë,
Më jepni ujë Qeutheri, ta pi të kulluar,
Petkën e Rizasë, hidhma përmbi shpinë.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Ku është parë në jetë, ngjarje si Qerbelaja,
Ku është rënia dëshmorë, me gjithë fëmijë,
Ku është parë më i ndershëm fis, se Ali Abaja,
Ku është parë ajo qëndresë me qindra mijëra.

Ej Nuri çeshmi Ahmedi Myftar, Ja Hysejn!
Ve jadigjari Hajderi Qerr- rrar Ja Hysejn!

Ah! Hysejn! Vah! Hysejn!
Shah Hysejn! Penah Hysejn!
Myryv-vet Ja Hysejn!
El medet, Ja Hysejn!

BISMIL – LAHIRR – RRAHMANIRR – RRAHIM!

Në Kuranin e zbritur nga ne, për të gjithë besimtarët e të mirët, sigurohet lumturia e mëshira, kurse zullumqarëve u shtohen dënimet dhe vuajtjet.
Zoti i uroftë e i bekoftë! Zoti i uroftë e i bekoftë! Zoti i uroftë e i bekoftë të gjithë ata, që dhurojnë tek nevojtarët!

O Zoti ynë! Ti je i parë e i mbrapëm, para e mbas çdo gjëje! Ti je i dukur dhe i pa dukur dhe mbi Ty dhe nën Ty s'ka gjë! Ti je i madh e i ndershëm e gjykatës i drejtë!

O Zot i Madh! Ti ke qenë i parë, para çdo sendi e do të jesh gjithmonë mbas çdo sendi. Ti që je më i afërt ndaj meje nga delli i qafës. Ti je punëtor dhe bën çdo send që dëshiron. Ti që hyn në mes të njeriut e zemrës së tij. O Ti që je i dukshëm lartë e poshtë, kudo e tek do! O ti që ndjen e sheh çdo send e nuk i përngjan asnjë gjëje! O Ti që ke zotësi për çdo gjë!

O Perëndi! Na i prano lutjet tona dhe na i plotëso dëshirat e nevojat tona, për hatër të Hazretit Mustafait, të Hazretit Ali Myrtezait, fëmijëve e të fisit të tyre të pastër e të kulluar!

I lëvduar qoftë Zoti Madh që pranoi pendimin e Profetit Adem e të Havasë dhe i fali gabimet të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që e ngriti në qiell Profetin Idriz të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që qëndroi gjëmin e Profetit Nuh në vendin Xhudi të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar Zoti Madh, që ndihmoi e shpëtoi Profetin Ibrahim nga zjarri i Nemrudit, të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar Zoti Madh, që i dëgjoi dhe i pranoi thirrjet e Profetit Musa e të Harunit, kur kishin nevojë, të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që i shtoi diturinë Hizer Pejkamberit të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që e mëshiroi dhe i fali gabimin Profetit Daut, të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që ngushëlloi Profetin Jakub të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që e shpëtoi Profetin Jusuf nga pusi pa pësuar asgjë, të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që e shpëtoi Profetin Jonuz nga barku i peshkut, të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që e shpëtoi nga sëmundja e gjatë Profetin Ejub, të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që e krijoi dhe errësirën të dhjetën ditë të Muharremit!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që na dhuroi këtë ditë, për të ndarë dritën nga errësira dhe na bëri të njohim armikun e vërtetë, d.m.th. veset tona!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që Hazretin Imam Hysenin e pajisi me cilësitë e larta të durimit, kundrejt mizorive më çnjerëzore, që ju bënë Atij, fëmijës, fisit dhe të besuarve të Tij, nga zotëruesit e tahmahut për grada, për sedër, për mall e për të gjitha madhështitë, gjakpirësit Jezid i Mavijes, i cili donte të zhdukte diellin e vërtetë të Njerëzimit, për t'u paraqitur vetë si trashëgimtar i atij fisi, Zotërues mbi popuj e kombe!

Mallkimi i Zotit, i gjakut të Qerbelasë, i të persekutuarve në shekuj e breza për këtë qëllim, i të

gjithë njerëzve të pastër e të urtë në botë, rëndoftë mbi Jezidin e pasuesit e tij të djeshëm e të sotëm!
I lëvduar qoftë Zoti Madh, që mbrojti një shkëndijë, një kandil të kësaj udhe, nga kombi i mallkuar e gjakpirës, fëmijën trembëdhjetë vjeçarë në moshë, por plak njëmijëvjeçar në mendje, Imami Zejnel Abedinin, se prej këtij e mori vesh njerëzija, se cilët janë shërbëtorët e vërtetë, që përpiqen për paqen e lumturinë e tyre dhe në anën tjetër njohu ata, që mbajnë petkat e një shërbëtori të njerëzimit dhe flasin me gjuhën e një shërbëtori, por që shtypin dhe terrorizojnë për interesat e tyre!

Për ata që dëgjojnë, për ata që vajtojnë, për ata që ligjërojnë, Zoti i bekoftë këtë ditë!
Për ata që shërbejnë rreth kësaj drite dhe për të gjithë të mirët e njerëzisë, Zoti i bekoftë!
Për shenjtërinë e këtij këndimi dhe për të gjithë librat e shenjtë, Zoti i bekoftë!
Për mirësinë e Pejgamberanëve dhe për dashurinë e Hatemi – Nebijine Hazreti Muhamed Mustafait, Zoti i bekoftë!
Për madhështinë shpirtërore dhe për lartësinë e figurës së shenjtë të Hazreti Alij – jyl Myrtezait, Zoti i bekoftë!
Për zonjën e madhe Mëmën Hatixhe dhe bijën e saj Virgjëreshën Fatime, Zoti i bekoftë!
Për dritë-dhënësin dhe dhembshurinë, mallëngjimin e Imamëve Hasan – Hysen, Zoti i bekoftë!
Për të gjithë Imamët, Masumet dhe për Qemerbestët e Imam Aliut, Zoti i bekoftë!
Për dritën e shenjtorëve Plak Haxhi Bektashi Veliut, Diellin e Horosanit dhe zgjuajtësin e lindjes e të Perëndimit dhe mësuesin e njerëzimit, Zoti e bekoftë!
Për këshilltarët e shkëlqyer të Hynqar Haxhi Bektashi Veliut: Sejid Ballëm Sulltan, Sejid Xhemalydin Sulltan, Sari Ismail Sulltan, Haxhem Sulltan, Sejidi Ali Sulltan, Karadonlli Xhan Baba Sulltan, Sari Salltëk Sulltan, Abdall Musa Sulltan, Kajgusez Sulltan, si dhe shpirtrat e atyre njerëzve të drejtë, që u ndryshuan nga kjo jetë:
Dedegjane, Halifegjane, Myxherredane, Babagjane, Kalenderane, Dervishane, Myhibane, Ashikane, Sadikane, Zoti i bekoftë!
Për rrojtjen e njerëzisë, shiun nga qielli, dridhjet nga toka, shëndetin nga era, Zoti i bekoftë!
Për të gjithë Patriotët e vërtetë e të pastër, që dëshërojnë kthimin në vendin e në shtëpinë e tyre, Zoti i bekoftë!
Për të mbeturit anije thyer në mes të detërave të mëdhenj e të tmerrshëm, Zoti i bekoftë!
Për njerëzit e mjeruar dhe të vobektë, të mbetur në mes të udhëve, pa plang e pa shtëpi, për bonjakët e jetimët dhe mëmat e tyre, Zoti i`u dhëntë përdëllim e i bekoftë!
Për lumturinë e njerëzisë së paqtuar, nga Lindja në Perëndim dhe për dashurinë e tyre, Zoti i bekoftë!
Për Shqipërinë e Shqiptarët, Zoti dhëntë vëllazëri të fortë, lulëzim, mbarësi në çdo punë, begati shëndet, fuqi të fortë, karakter të pa tundur, lavdi, nder e mirësi dhe të gjitha këto Zoti i bekoftë!
Për lavdinë, shëndetin, jetën e gjatë dhe lumturinë e Kryetarit të Republikës së Shqipërisë dhe për veprat e tija të mbara, Zoti e bekoftë!
Për lavdinë, shëndetin, forcën e rregullin e Ushtrisë Heroike Shqiptare, me oficerët e saj, Zoti i bekoftë!
Për shëndetin e atdhetarëve të vërtetë, shkrimtarëve, pedagogëve dhe gjithë nëpunësave të shtetit, që punojnë për lulëzimin e Republikës së Shqipërisë, Zoti i bekoftë!
Për lartësinë e shpirtrave të Pejgamberanëve: Ademi Safijullah, Nuh Nexhijullah, Ibrahim Halilullah, Musa Qelimullah, Isa Ruhullah e Muhamed Resulullah, Zoti i bekoftë!
Për zgjuajtësit e popullit Shqiptar dhe udhërrëfenjësit e mirë: Kasem Baba Kosturi, Sari Salltëk Ohri, Hysen Baba Konica, Hasim Baba Gjirokastra, Shememi Baba Kruja, Abdulla Baba

Melçani, Sersem Ali Baba Tetova, Nasibi Sulltan Frashëri, Tahir Baba Prishta, Xhefai Baba Elbasani, Zoti i bekoftë!
Për dritën e Abaz Ali Sulltanit, për kqyrsit tanë, tek i Shenjti Mal i Tomorrit, që Shqipëria e tërë në kohë të rrezikshme, shtie sytë ndaj tij dhe i falet duke i kërkuar shpëtim, Zoti i bekoftë!
Paçim për ndihmë të përhershme lartësinë madhështore të Profetësisë, shpirtin e ndritshëm të Hazretit Muhamed, shenjtërinë e diturinë e të Tretëve, të Pestëve, të Shtatëve, të Dyzetëve, të Njëmij e Njëve dhe të gjithë Profetëve, Evlijave dhe burrave të fshehur!

O Zot i Madh! Pranojeni këtë lutje që bëmë, për shpirtrat e të gjithë atyre, që janë të besuarit e Profetit, për dëshirën e shumë dashamirësve, të Udhës së Muhamed–Aliut, për hak të Kuranit e të gjithë Piranëve!

O Zot i vërtetë! Vijmë në portën e lartë madhështore tënden kryeultësisht dhe lutemi, që për himetin e ndritshëm të Hazreti Muhamedit, për qeremin e Imam Aliut dhe për dritën e Pirit tonë, Hynqar Haxhi Bektashi Veliut dhe për durimin shembullor, që treguan dëshmorët e Qerbelasë, veçanërisht për trupin e lyer në gjak të Imam Hysenit, që doli në Mejdan të Xhefasë, pranoni lutjen tonë!

Për shpirtin e pa vdekur të …….
themeluesi i këtij çiraku dhe udhërrëfenjësit pasardhës…… Zoti e bekoftë!

Të gjitha varfat, shërbëtorët e këtij çiraku, të gjithë myhibët e qëndruar përqark këtij çiraku, të gjithë ashikët dhe populli i ndershëm pranë dhe rreth këtij çiraku, qofshin të bekuar!

Të gjithë çirakët e Shqipërisë, si dhe ata të Botës Bektashiane me gjithë shërbyesit dhe gjendjen e tyre, Zoti i bekoftë!

Të gjithë vëllezërit e urtë që ndodhen në faqen e dheut, Zoti i bekoftë!

Të gjithë ata njerëz të mirë dhe të urtë, që me metodat e tyre mundohen dhe punojnë për edukimin dhe përmirësimin e shoqërisë njerëzore, Zoti i bekoftë!

JA IMAM!

NEFES I ABAZ ALIUT
Shkëputur nga vepra "Lulet e verës" Naim Frashëri

Engjëll! Që m'u qasë pranë
Nga i madhi Zot,
Pse më rrëfen Qerbelanë?
A do të derth lot?

moj fush'e Qerbelasë!
Që më rri ndër sy,
Plot me gjak t'Ali-Abasë,
Vallë ç'ësht' ay?

Ç'ësht' ay që shkon kaluar,
Ikën si veriu,
Me dy-tri foshnja në duar?
Ësht' Abas-Aliu!

Shpije foshnjatë në lumë,
Se s'durojnë dot,
I ka marrë etja shumë,
E qajnë me lot!

Ujët ua kanë prerë
Janë në shtrëngim,
Si të varfër e të mjerë.
Në zi, në hidhërim.

Më ç'do an' i ka rrethuar
Kombi faqezi,
Komb'i lik i xnallëkuar,
Posi mizëri!

Nëpër mest të ushtrisë
Të armikut shkon,
Si ëngjëll i Perëndisë,
Nd'erë fluturoni

Shigjetat si breshërimë
I vine ngado,
Ay posi vetëtimë
Ikën nëpër 'to.

Shërbtor'e njerëzisë
Shigjeta s'e çpon
Edhe nder'e trimërisë
Zoti e mburon.

Ç'ikën ay kal'i shkretë,
Mi dhë nuk shkel
Nga potkonjtë q'ikën shpejtë
Zjar e flak'i del!

moj kafshëz e uruar,
Mos shkel për mi dhë.
Se'shtë gjaku i bekuar,
Ikë nëpër rë!

Frat, o more lum'i shkreti
Mos këndo pa qaj,
Derth lot e rënko përjetë,
Mos qesh paskëtaj;
Se Hysejn'e Fatimesë
Me fare të ti,
E vranë komb'i pabesë,
Kombi faqezi.

Abas Aliu zu' Tomorë,
Erdhi afër nesh,
Shqipërija s'mbet e gjorë,
Se Zoti e desh.

Hysejni desh njerëzinë,
Dhe për të u vra,
Për të shpëtuar njerinë
Ra nde Qerbela.

Hysejni 'shtë dashurija
Që fatbardhëson,
Buron soj e miqësija,
Qe na lartëson.

Jeziti'shtë egërsirë,
Që sjell ligësi,
Dhe s'del soje pun'e mirë
Po dëm edhe zi.

Kushdo që bën mirësinë
E ka njerëzi
Ka besuar Alinë,
Dhe udhën e ti.

Gënjeshtra 'shtë Mavijeja,
Që prishe dhe sot,
E drejta 'shtë Fatimja,
Dhe i madhi Zot.

E liga është Mervani
Qënxin e shkretën,
Djallëzija 'shtë Syfjani,
Që dhe sot dërmon.

Imamë të dymbëdhjetë
Nga der'e Aliut,
Hoqn'e vuanë ndë jetë
Për nder të njeriut.

Zotërinj! Ju qofsha falë!
Që hoqtë për ne,
Na late vetëm një fjalë
Për bes'e fe.

IMAM HUSAYN

Imam Husayn is the second son of Imam Ali and Fatima Zehra, the nephew of the Hadhrat Prophet Mohammad (a.s.). He is the third of the twelve Imams and the fifth from the family of Ehli-Bejt.

He was born in the blessed City of Medina on the 5th Arabic Lunar Month of Shaban, Tuesday day, the 4th year of Emmigration.

It was the Prophet Muhammad Himself Who named him as Husayn. He used to have those last names: Zeqi, Shepir, Shehid, Sept. Both Imam Husayn and Imam Hassan have been praised with divine qualities and with innumerous prophetic attributes, as it makes an obligation for every Muslim believer to respect and love them. Imam Husayn resembled to his father Imam Ali from his upper part of the body, while resembled to his Grandfather Hadhrat Muhammed from his lower part of the body. After the passing away of his Grandfather, Hadhrat Mohammed, he always remained very close to his Father so he got all of the knowledge and education from the Father.

After the martyrdom of Imam Ali in Kufa, in the 40th year of Emmigration, he came back to Medina together with kids, when Imam Hassan signed a peace treaty with Muawijah.

Muawijah used all of the possible ways through letters and people to make Imam to give allegiance to his son,- Yazid as his successor, but he did not. After the passing away of Muawijah, his son, Yazid used every way to make Imam Husayn to obey to him, but Imam Husayn did not pledge allegiance to him.

Since he was not left in peace in Medina by the people of Yazid, Imam preferred going from Medina to the blessed city of Mecca.

Many delegates were sent to him In Mecca, by the city of Kufa, expressing their wish to have him as Halife in their place, swearing that they would hold the flag of Ehli-Bejt.

Imam Husayn sent there his cousin Muslim Ukail to inform the population there that he accepts their proposal, but they killed him and his two sons.

